



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:202895
Datë: 12.01.2024
Numri i dokumentit: 05184339

PA1.nr.586/23

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Ferit Osmani anëtar, me praktikantin gjyqësor Arben Arifi si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit J.F., nga fshati..., K. Gjilan, për shkak të vepres penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.806/19 të datës 01.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 28.Dhjetor 2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.806/19 të datës 01.03.2023, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.806/19 të datës 01.03.2023, i akuzuari J.F., konform nenit 364 paragrafi 1 nën par.1.3 të KPPRK-se, është liruar nga akuza për shkak të vepres penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së,

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kërkese pasurore juridike nuk ka pasur ngase i dëmtuari J.R., nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka parashtruar kerkese pasurore juridike.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Gjilan për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit

penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta shpallë fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe t'i shqiptoj një dënim meritor sipas ligjit.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u shkjaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, me shkresën e vet PPA.II.nr.625/23 të datës 10.05.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta shpallë fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe t'i shqiptojë dënim meritor sipas ligjit apo të njëjtin ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe gjeti se:

- **Ankesa nuk është e bazuar.**

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale Prokuroria Themelore në Gjilan me ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12 të KPPRK-së, ngase ky aktgjykim nuk është përpiluar në pajtim me nenin 369 të KPPRK-së për faktin se nuk janë dhënë arsyet e mjaftueshme dhe të qarta mbi faktet vendimtare kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza si dhe duke qenë se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me brendinë e tij, me arsyetimin si dhe faktet vendimtare dhe me përmbajtjen e provave materiale të administruara si në shkresat e lëndës, e të cilat shkelje aktgjykimin e bëjnë të paqëndrueshëm për çka të njëjtin duhet anuluar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjilan lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe konstatoi se të njëjtat nuk janë të bazuara ngase aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm dhe si i tillë përmban arsye të mjaftueshme përkitazi me faktet relevante të kësaj çështje juridiko penale si dhe faktet nga të cilat varet edhe aplikimi i drejte i dispozitave të ligjit penal, ngase në rastin konkret nuk është arritur që të vërtetohet se i akuzuari J.F., të ketë kryer veprën penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së, andaj edhe të njëjtin e ka liruar nga akuza, ngase në veprimet e të akuzuarit nuk plotësohen elementet e veprës penale për të cilat është akuzuar.

Sa i përket bazës ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike Prokuroria Themelore në Gjilan, me ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale gabimisht dhe në mënyrë jo të plote e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe se është i paqëndrueshëm konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se me vlerësimin e provave materiale dhe personale kinse nuk është vërtetuar se i akuzuari t'a ketë kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës dhe se sipas Prokurorisë nga provat e administruara në gjykatën e shkallës së parë deklaratës se të dëmtuarit të dhënë në cilësinë e dëshmitarit, deklaratës se dëshmitarit I.R., kopjet e mesazheve si dhe provat e tjera materiale është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale të lartcekur dhe se gabimisht gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se nuk ka pasur prova personale dhe materiale se i akuzuari të ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe se sikur këto prova dhe shkresat e tjera në lende të ishin vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë i akuzuari është dashur që shpallet fajtor e jo gjykata të nxjerrë aktgjykim

lirues me çka edhe në rastin konkret kur gjykata e shkalles se pare kur te akuzuarin e ka liruar nga akuza e ka shkelur edhe ligjin penal në favor të të akuzuarit.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjilan, lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe gjeti se pretendimet e tilla nuk janë të bazuara. Sipas kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se nuk ka prova të mjaftueshme që i akuzuari të ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor para gjykatës se shkalles se pare, e sidomos nga leximi i mesazheve te shkruara, ne asnjë nga mesazhet e deponuara ne shkresat e lëndës nuk është konstatuar fjala ‘*Kom me t’vra*’, por i akuzuari kishte përdorur fjalë fyese ndaj te dëmtuarit. Andaj, gjykata e shkalles se pare bazuar ne dispozitën e nenit 361 të KPPRK-së i cili parasheh qe gjykata e bazon aktgjykimin vetëm ne fakte dhe provat e proceduara ne shqyrtimin gjyqësore dhe detyrohet te vlerësoje çdo prove një nga një dhe ne lidhje me provat tjera dhe ne baze te vlerësimit te nxjerrët përfundim nëse fakti konkret provuar e që rastin konkret nuk ka arritur qe te vërtetohet qe i akuzuari e ka kryer veprën penale.

Andaj, gjykata e shkalles se pare ka ardhur ne përfundim se ne këtë çështje juridike-penale nuk ka prova te mjaftueshme se i akuzuari ta ketë kryer veprën penale, andaj, ne mungese te provave ka nxjerre aktgjykim lirues, e gjendjen faktike te vërtetuar nga ana e gjykata e shkalles se pare e vërteton edhe Gjykata e Apelit, me ç’rast konstaton se në rastin konkret kur të akuzuarin J.F. e ka liruar nga akuza drejtë e ka aplikuar edhe ligjin penal, andaj edhe pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjilan në lidhje me shkeljen e ligjit penal në favor të të akuzuarit i refuzoi si të pabazuara. Me ç’rast aplikoi edhe parimin *in dubio pro reo* te paraparë me nenin 3 par.2 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.586/23 më 28.12.2023

Procesmbajtës
Arben Arifi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetar i kolegjit,
Skender Çoçaj

Ferit Osmani
